

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 10584/2 Prot.

Tiranë, më 02/10/2024

URDHËR

Nr. 783 Datë 02 / 10 / 2024


PËR

MIRATIMIN E STATUTIT TË ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.198, datë 04.05.1993 “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 30, datë 17.01.2024 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit” dhe Statutit të EKB-së nr.325/2 prot., datë 25.02.2019, pasi shqyrtova praktikën e dërguar me shkresën nr. 1177, datë 22.08.2024;

URDHËROJ

1. Miratimin e statutit të “Entit Kombëtar të Banesave”.
2. Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij Urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2024

STATUTI I
ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Statusi

Enti Kombëtar i Banesave është institucion shtetëror me vetëfinancim, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit i pajisur me personalitet juridik, i krijuar për një kohëzgjatje të pacaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.198 datë 04.05.1993 “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave”, i ndryshuar.

Neni 2

Mbështetja ligjore

Enti Kombëtar i Banesave, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij mbështetet në:

- Ligjin Nr.7582 datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.198 datë 04.05.1993 “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave” i ndryshuar.

- Ligji Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar
- Ligji Nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,
- Ligji Nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar.
- Urdhërat dhe udhëzimet e ministrit të ministrisë përgjegjëse për strehimin, nga i cili ka varësinë institucioni;
- Aktet që rregullojnë funksionimin e veprimtarisë së Entit Kombëtar të Banesave (Statuti, Rregullore Mbi Organizimin dhe Funksionimin e institucionit dhe Rregullore Mbi Funksionimin e Këshillit Drejtues);
- Vendimet e Këshillit Drejtues të Entit Kombëtar të Banesave;
- Urdhërat, vendimet dhe udhëzimet e brendshme, të Drejtorit të Përgjithshëm të EKB-së;

Neni 3

Emërtimi dhe Selia

Emërtimi i plotë i institucionit është Enti Kombëtar i Banesave, dhe do të njihet me emërtimin e shkurtuar “EKB”.

Selia e Entit Kombëtar të Banesave (Drejtoria e Përgjithshme) ndodhet me adresë: Rruga e Kavajës, ndërtesa nr.80, hyrja 1, kati 5 (ish shtëpia botuese “Naim Frashëri”), Tiranë.

Drejtoria e Përgjithshme e EKB-së është e regjistruar pranë organit tatimor dhe ka vulën e saj në formë rrethore ku shkruhet:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

TIRANË

Adresa e faqes zyrtare të internetit të Entit Kombëtar të Banesave është: “www.ekb.gov.al”.

Neni 4

Objekti

Objekti kryesor i veprimtarisë së EKB-së është financimi, ndërtimi, shitja dhe blerja e banesave në kushtet e konkurrencës së lirë, për sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për vazhdimin e veprimtarisë, për mbështetjen e politikave sociale të strehimit dhe për sigurimin e banesave me kosto të ulët, në përputhje me Ligjin Nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të miratuar në zbatim të tij.

Neni 5

Territori

EKB zhvillon aktivitetin e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me Drejtorinë e Përgjithshme dhe degët rajonale përkatëse.

KAPITULLI II

BURIMET E FINANCIMIT DHE KAPITALI I EKB-SË

Neni 6

Burimet e Financimit

Për plotësimin e detyrave, objektivave dhe të drejtave të tij, EKB mund të sigurojë dhe investojë fonde nga këto burime:

- a) të ardhura që i caktohen EKB-së nga buxheti i shtetit dhe nga buxhetet e organeve të vetëqeverisjes vendore;
- b) të ardhura nga huatë dhe kreditë e institucioneve financiare vendase dhe të huaja;
- c) të ardhura nga donatorë vendas edhe të huaj;
- d) të ardhura të realizuara nga investimi i fondeve të vetë EKB-së;
- e) të ardhura të realizuara nga privatizimi i banesave shtetërore;
- f) të ardhura nga shitja e banesave;
- g) të ardhura të tjera nga pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme që mund të sigurojë EKB.

Neni 7

Kapitali themeltar

Kapitali i EKB-së përbëhet nga:

- a) Kapitali themeltar prej 5 (pesë) milion lekë, i akorduar nga Këshilli Ministrave me Vendimin Nr.198 datë 04.05.1993 “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave”, i ndryshuar.
- b) Fondet rezervë të krijuara gjatë veprimtarisë ekonomike dhe financiare të vetë EKB-së.

Neni 8

Përdorimi i fitimit

Fitimi i EKB-së, pas zbritjes së detyrimit tatimor përdoret:

- a) Për krijimin e rezervës së kapitalit.
- b) Për krijimin e rezervës për zhvillim.
- c) Për krijimin e rezervës për ndihmë sociale.
- d) Për krijimin e rezervës për shpërblim suplementar të punonjësve.
- e) Për krijimin e rezervave të tjera.

KAPITULLI III

STRUKTURA ORGANIZATIVE E EKB-SË

Neni 9

Organet Drejtuese

Organet drejtuese të Entit Kombëtar të Banesave janë:

- a) Këshilli Drejtues.
- b) Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 10

Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues është organi më i lartë vendimarrës i EKB-së.

Përbërja dhe emërimi i Këshillit Drejtues janë të përcaktuara në aktin e krijimit të institucionit me VKM Nr.198 datë 04.05.1993 “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave”, i ndryshuar.

Neni 11

Përbërja dhe Emërimi

Këshilli Drejtues i EKB-së, përbëhet nga 7 anëtarë, që emërohen:

- 2 (dy) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për strehimin;

- 1 (një) përfaqësues nga aparati i Kryeministrit;
- 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet vendore;
- 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën;
- 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- Drejtori i Përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave;

Anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen nga ministri përgjegjës për strehimin, i cili ka në varësi EKB-në, në bazë të kandidaturave të propozuara dhe paraqitura nga institucionet përkatëse.

Anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen për një periudhë katër vjeçare dhe me të drejtë riemërimi.

Anëtarët e Këshillit Drejtues mund të largohen nga detyra para përfundimit të afatit 4 vjeçar, nga organi i cili i ka emëruar, me propozim të institucioneve që përfaqësojnë, vetëm për shkaqe të përligjura dhe me një vendim të motivuar: a) dorëheqje; b) vdekje; c) mungesë e pajustificuar në tre mbledhje radhazi; d) vendim të organeve gjyqësore ose në ndjekje penale.

Në rastet e largimit të një përfaqësuesi të Këshillit Drejtues, ministri që ka në varësi EKB-në, njofton institucionin që ka propozuar këtë kandidaturë dhe kërkon zëvendësimin e tij.

Në rast largimi, dorëheqje ose vdekje të një anëtari të Këshillit Drejtues, ky zëvendësohet nga institucioni që e ka propozuar, jo më vonë se në mbledhjen pasardhëse të Këshillit Drejtues.

Anëtari zëvendësues gëzon të drejtën e anëtarit të Këshillit Drejtues deri në përfundimin e mandatit të anëtarit që ka zëvendësuar.

Këshilli Drejtues drejtohet nga Kryetari, i cili është përfaqësues i ministrit përgjegjës për strehimin që ka në varësi EKB-në dhe caktohet nga Ministri përgjegjës për strehimin.

Neni 12

Mbledhja e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues mbledhet sa herë e kërkon interesi i institucionit, por si rregull një herë në muaj.

Të drejtën e thirrjes së mbledhjes së Këshillit Drejtues e ka Kryetari i Këshillit Drejtues të EKB-së. Këshilli Drejtues mund të mbledhet edhe me kërkesë të shumicës së anëtarëve të Këshillit.

Mënyrat e thirrjes së Këshillit Drejtues si dhe të gjitha procedurat e mbledhjes deri në vendimarrje, përcaktohen në Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit Drejtues të EKB-së.

Neni 13

Shpërblimi i Këshillit Drejtues

Pagesa e anëtarëve të Këshillit Drejtues kryhet bazuar në pjesëmarrjen në mbledhjet e zhvilluara, por jo më shumë se për një mbledhje në muaj.

Pagesa e Këshillit Drejtues do të bëhet në analogji me pagesën e përcaktuar në shkronja “a” të pikës “6” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.570 datë 3.10.2018 “Për Këshillat Mbikqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetërore”.

Neni 14

Vendimet e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues është një organ vendimarrës, i cili merr vendime dhe lë detyra me shumicë të thjeshtë votash të përbërjes së tij, për të gjitha problemet e menaxhimit të EKB-së.

Këshilli Drejtues përveç kompetencave të njohura nga Ligji nr.7582 datë 13.07.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, i ndryshuar, si dhe ato të përcaktuara në VKM nr.198 datë 04.05.1993 “Për Krijimin e Entit Kombëtar të Banesave” i ndryshuar, ka edhe këto kompetenca:

- a) Shqyrton aktet që rregullojnë funksionimin e EKB-së (Statutin, Rregulloren Mbi Organizimin dhe Funksionimin e institucionit, si dhe Rregulloren e Këshillit Drejtues) dhe i dërgon për miratim tek ministri përgjegjës për strehimin.
- b) Shqyrton dhe miraton Strukturën dhe Organigramën e EKB-së, të propozuar nga Drejtori Përgjithshëm (krijimin, shkrirjen, bashkimin ose ndarjen e strukturave të EKB-së).
- c) Miraton programin ekonomik-financiar një vjeçar dhe programin afatmesëm të veprimtarisë të EKB-së.
- d) Shqyrton Analizën e veprimtarisë së EKB 6 mujore dhe vjetore dhe miraton Analizën e aktivitetit vjetor, e cila i dërgohet Ministrit përgjegjës për strehimin)
- e) Miraton planin strategjik dhe vjetor të Sektorit të Auditimit të EKB-së, kartën e auditimit si dhe shqyrton nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna për periudhën vjetore dhe rezultatet e auditimeve të kryera për periudhën 6-mujore dhe vjetore, duke miratuar këtë të fundit.
- f) Miraton marrëveshjet me organet e vetëqeverisjes vendore, kompanitë ose individët për realizimin e projekteve me interes të përbashkët.
- g) Miraton bilancin kontabël dhe pasqyrat financiare të veprimtarisë të EKB-së, pasi të jetë kontrolluar dhe miratuar nga eksperti kontabël i autorizuar, i cili caktohet nga ministri përgjegjës për strehimin.
- h) I propozon ministrit përgjegjës për strehimin që ka në varësi EKB-në, largimin e anëtarit të Këshillit Drejtues, referuar nenit 11 të këtij statuti.
- i) I propozon ministrit përgjegjës për strehimin jo më pak se dy kandidatura për emërim në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të EKB-së dhe Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të EKB-së.
- j) I propozon ministrit përgjegjës për strehimin largimin nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të dhe Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të EKB-së.
- k) Miraton emërimin në detyrë të Drejtorëve të Drejtorive, të Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit, të Drejtorisë së Përgjithshme, si dhe të Drejtorëve të Degëve Rajonale, ndërmjet dy ose më shumë kandidaturave të propozuara dhe paraqitura nga Drejtori Përgjithshëm i EKB-së.
- l) Miraton largimin (lirim/shkarkim) nga detyra të Drejtorëve të Drejtorive, të Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit, të Drejtorisë së Përgjithshme, si dhe të Drejtorëve të Degëve Rajonale.

- m) Miraton procedurat për shitjen e banesave (apartamenteve dhe ambienteve të shërbimit), që ndërton EKB me fondet e veta.
- n) Miraton çmimin fillestar të shitjes së njësive të shërbimit dhe garazheve, shitja e të cilave parashikohet të kryhet me ankand.
- o) Miraton çmimin e rivlerësuar/zhvlerësuar të apartamenteve/njësive të shërbimit dhe garazheve që mund të mbesin stok për një kohë të gjatë, pas raportit të vlerësimit.
- p) Miraton strukturën dhe nivelet e pagave të punonjësve të EKB-së, si dhe i dërgon për miratim tek ministri përgjegjës për strehimin.
Miraton masën e shpërblimit të punës për punonjësit e EKB-së pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe i dërgon për miratim tek ministri përgjegjës për strehimin.
Shqyrton dhe miraton fonde shtesë për lidhje kontrate shtesë, kur nevoja për punë/shërbime/furnizime shtesë plotëson kushtet e parashikuara dhe përcaktuara në nenin 127 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
- q) Miraton shitjen ose dhënien me qira të aktiveve afatgjata materiale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- r) Shqyrton problematika të ndryshme të dala gjatë veprimtarisë së EKB-së.

Vendimet dhe detyrat e Këshillit Drejtues janë të detyrueshme për zbatim nga Drejtori i Përgjithshëm, si dhe strukturat e EKB-së.

Neni 15

Drejtori Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson Entin Kombëtar të Banesave dhe emërohet e lirohet nga detyra nga ministri përgjegjës për strehimin, me propozim të Këshillit Drejtues të EKB.

Neni 16

Të drejtat dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm ushtron të drejtat dhe detyrat si më poshtë:

- a) Përfaqëson institucionin në të gjithë veprimtarinë e tij administrative dhe financiare.
- b) Përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me institucionet e tjera, në marrëdhënie me të tretët, promovon aktivitetin e EKB-së me kompetencë të plotë veprimi, me përjashtim të kompetencave që ligji ia ka ngarkuar Këshillit Drejtues.
- c) Miraton përgatitjen e materialeve nga administrata e EKB-së dhe i paraqet ato në mbledhjen e Këshillit Drejtues sipas rendit të ditës së përcaktuar.
- d) Emëron në detyrë punonjësit e EKB-së, në përputhje me strukturën e miratuar duke përjashtuar emërimet që janë kompetencë e Këshillit Drejtues të EKB-së.
- e) Ndërpret marrëdhëniet e punës me punonjësit e EKB-së, duke përjashtuar largimet që janë kompetencë e Këshillit Drejtues të EKB-së:
 - me kërkesën e tyre;

- kur gjenden me shkelje disiplinore të përsëritura;
 - kur nuk kryejnë detyrat e dhëna në mënyrë të përsëritur, të përcaktuara në Rregulloren e EKB-së;
 - kur largimi del si nevojë e ndryshimeve të strukturës dhe organikës së miratuar nga Këshilli Drejtues i EKB-së;
 - raste të tjera të përcaktuara në ligjin Nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.
- f) I propozon Këshillit Drejtues me kandidatura alternative emërimin, si dhe largimin nga detyra të Drejtorëve të Drejtorive në Drejtorinë e Përgjithshme, të Përgjegjës të Sektorit të Auditimit, si dhe të Drejtorëve të Degëve Rajonale.
- g) Në rastin kur pozicioni i Drejtorit/Përgjegjës të Sektorit në Drejtorinë e Përgjithshme ose i Drejtorit në Degën Rajonale mbetet vakant, komandon një punonjës brenda strukturave të EKB-së të kryejë funksionin përkatës deri në miratimin e emërimit për këtë pozicion nga Këshilli Drejtues, dhe informon për këtë komandim Këshillin Drejtues në mbledhjen e tij të radhës.
- h) Vendos masa disiplinore për Drejtorët/Përgjegjës të Sektorëve në Drejtorinë e Përgjithshme, për Drejtorët e Degëve Rajonale, të cilët mund të ushtrojnë të drejtën e ankimit pranë organit që i ka emëruar, si dhe vendos masa disiplinore për të gjithë punonjësit e EKB-së.
- i) Nxjerr urdhëra, udhëzime vendime/autorizime dhe rregullore të brendshme në zbatim të akteve ligjore e nën ligjore për drejtimin e EKB-së, si dhe ndjek e kontrollon zbatimin e tyre.
- j) Në mungesë të tij i delegon kompetenca Zv/Drejtorit të Përgjithshëm ose një punonjësi të autorizuar prej tij.

Neni 17

Organizimi

Enti Kombëtar i Banesave është organizuar në Drejtori të Përgjithshme dhe Degë Rajonale.

Neni 18

Drejtorja e Përgjithshme

Drejtorja e Përgjithshme e EKB-së përbëhet nga Drejtoritë, të cilat kanë varësi nga Drejtori i Përgjithshëm, si dhe Sektori i Auditimit në varësi të drejtpërdrejtë të Këshillit Drejtues të EKB-së.

Drejtimi dhe administrimi i Drejtorive/Sektorëve të Drejtorisë së Përgjithshme, ushtrohet nga Drejtori i Drejtorisë/Përgjegjësi i Sektorit, dhe në rast të mbetjes së pozicionit vakant nga punonjësi i komanduar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Drejtori i Drejtorisë/Përgjegjësi i Sektorit, i propozon Drejtorit të Përgjithshëm, masa disiplinore për punonjësit në varësi të tij, si dhe fillimin e procedurës për largimin e tyre nga detyra (puna).

Të drejtat dhe detyrat e strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të EKB-së, përcaktohen në “Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e EKB-së”.

Neni 19

Degët Rajonale

Degët Rajonale varen nga Drejtoria e Përgjithshme e EKB-së.

Drejtimi dhe administrimi i Degëve Rajonale, ushtrohet nga Drejtori i Degës, dhe në rast të mbetjes së pozicionit vakant nga punonjësi i komanduar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Drejtori i Degës Rajonale të EKB-së, i propozon Drejtorit të Përgjithshëm masa disiplinore për punonjësit në varësi të tij, si dhe fillimin e procedurës për largimin e tyre nga detyra (puna).

Degët Rajonale i dërgojnë Drejtorit të Përgjithshëm, në afate të përcaktuara dhe sa herë kërkohet, bilancin verifikues me relacion shoqërues, evidenca statistikore, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm.

Degët Rajonale kanë zyrat përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Ato krijohen kryesisht në bazë qarku.

Degët Rajonale janë të regjistruara pranë organit tatimor dhe kanë vulën e tyre në formë rrethore.

Të drejtat dhe detyrat e Degëve Rajonale të EKB-së, përcaktohen në “Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e EKB-së”.

KAPITULLI IV RREGULLIMET E MARRËDHËNIEVE TË PUNËS

Neni 20

Baza ligjore e marrëdhënieve të punës

Marrëdhëniet e punës si dhe kontratat e punës së punonjësve të EKB-së, rregullohen në bazë të Ligjit Nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ndërsa marrëdhëniet administrative rregullohen sipas Kodit të Procedurës Administrative dhe akteve ligjore/nënligjore në fuqi.

KAPITULLI V KONTABILITETI DHE BILANCI I EKB-SË

Neni 21

Viti Financiar

Viti financiar i EKB-së është vit kalendarik dhe përfshin periudhën kohore nga data 1 Janar deri në datë 31 Dhjetor të vitit.

Neni 22

Pasqyrat Financiare

EKB, në përputhje me Ligjin nr.25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, mban llogari, regjistra dhe pasqyra financiare për çdo vit financiar, të cilat duhet të pasqyrojnë saktë gjendjen financiare të EKB-së.

Pasqyrat financiare të çdo viti financiar auditohen dhe çertifikohen nga një ekspert kontabël i autorizuar, sipas afateve të përcaktuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 23

Depozitimi i pasqyrave financiare në organet përkatëse

Bilanci kontabël dhe pasqyrat financiare të veprimtarisë së EKB-së, pas miratimit nga Këshilli Drejtues, i dërgohet organit tatimor, brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, si dhe depozitohen në Ministrinë përgjegjëse për financat (Dega e Thesarit)

Me kërkesën e tyre, ky dokumentacion i dërgohet edhe institucioneve financiare vendase dhe të huaja në rastet kur ato i kanë akorduar EKB-së hua, financime, kredi ose donacione.

Neni 24

Shlyerja e Detyrimeve ndaj shtetit

EKB i krijuar si institucion shtetëror dhe person juridik paguan detyrime për tatimin mbi fitimin, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor, tatimi mbi të ardhurat personale (TAP), si dhe çdo detyrim tjetër ndaj shtetit, në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

KAPITULLI VI

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25

Falimentimi dhe Likuidimi

Në rast falimentimi të institucionit, likuidimi do të bëhet sipas Ligjit nr.110/2016 datë 27.10.2016 “Për falimentimin”.

Neni 26
Hyrja në Fuqi

Ky statut hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Ministri përgjegjës për strehimin.

Statuti i Entit Kombëtar të Banesave përmban 26 (njëzet e gjashtë) nene.

MIRATOHET
BLENDI GONXHJA
MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

